

“ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE”

RAPORT SHKENCOR NË PËRFUNDIM TË FAZËS SË PARË

Institucioni realizues :

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Organizmi dhe Programi financues :

AKTI, PKSHZH

Drejtues i Projektit : Prof. Dr. Ardian Marashi

Projekti dhe Programi kuadër

Projekti “Enciklopedia Shqiptare” është nisur në kuadër të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe të Zhvillimit, drejtimi Shkencat Sociale. Kontrata mes institucionit zbatues, Qendra ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike (QSA), dhe organizmit financues, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Informacionit (AKTI), është lidhur në korrik të vitit 2010. Në dhjetor të vitit 2012 financimi i Projektit është ndërprerë nga AKTI, për mungesë fondesh. Në këto kushte, Projekti ka arritur të përmbushë vetëm detyrat e fazës së parë të zhvillimit, por është gati të vazhdohet e të përfundohet brenda dy vitesh, nëse financimi do të mund të realizohet sipas parashikimit fillestar.

“Enciklopedia Shqiptare” dhe “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”

Dallimi mes *Enciklopedisë* dhe *Fjalorit enciklopedik* është thelbësor.

Fjalori enciklopedik kombëtar është një lloj inventari i përgjithshëm, një bazë të dhënash e nevojshme për të përcjellë një informacion fillestar, me karakter përkufizues, që mundëson një njohje të sipërfaqshme fizike të objektit të synuar.

Enciklopedia kombëtare është një inventar i detajuar dhe i thelluar, me karakter orientues, që garanton njohuri të sigurta të objektit të synuar, si edhe të ndërlidhjeve të tij shumëplanëshe.

Momenti historik dhe nevoja për Projektin “Enciklopedia Shqiptare”

Jo çdo komb ka arritur që ta ketë tashmë Enciklopedinë e vet kombëtare. Kjo është një dëshmi kulturore moderne dhe një vepër moderne kulture.

Ky modernitet ka nisur në shekullin XVIII për Europën perëndimore.

Bashkëpunëtorët e këtij Projekti kanë besimin e patundur se shekulli XXI shënon pikënisjen e modernitetit shoqëror e kulturor shqiptare, se hartimi dhe botimi dygjuhësh i Enciklopedisë kombëtare është thjesht një çështje kohe, një detyrë e cila do të përmbushet së shpejti dhe në parametrat që shtron një angazhim i këtillë sot, në epokën e globalizmit gjeokulturor dhe të mbretërisë së komunikimit.

Objektivat kryesore

- ❖ Realizimi për herë të parë i një enciklopedie kombëtare shqiptare, mbi baza shkencore;
- ❖ Pasqyrohen në këtë enciklopedi në mënyrë sintetike të dhënat e plota e të sakta të botës shqiptare që nga lashtësia e deri në ditët tona;
- ❖ Publikut shqiptar dhe të huaj i vihet në dispozicion një informacion sa i thelluar aq edhe sintetik e i gjithanshëm për dukuritë, ngjarjet, vendet e kujtesës kombëtare dhe personalitetet e botës shqiptare, si dhe për realizimet në fushat e ndryshme të jetës sociale, politike, kulturore e shkencore;
- ❖ Krijohet një bazë të dhënash e re dhe e plotë, gjithëpërfshirëse e ndërdisiplinore, e cila do të ndihmojë në zhvillimin e shkencës dhe të kulturës në të ardhmen, duke shërbyer si referencë kulturore e shkencore gjithëkombëtare.
- ❖ Publiku dhe studiuesit e huaj kanë më në fund në dorë një vepër e cila u flet atyre për botën shqiptare, për mjedisin, për të ndodhurat e hershme dhe për zhvillimet e sotme, në formën dhe mënyrën si e njohim ne shqiptarët veten dhe jo siç na kanë paragjykuar e na paragjykojnë fqinjët sidomos ballkanikë, të cilët qysh prej dy shekujsh, përmes botimeve dhe institucioneve të tyre, luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e opinionit ndërkombëtar për shqiptarët, për historinë dhe identitetin e tyre.

Problemet e trajtuara

- Është ngritur redaksia e përgjithshme e Enciklopedisë Shqiptare e përbërë nga personalitete të njohura të shkencës dhe kulturës të të gjitha trevave shqiptare.
- Është kryer studimi i shumë enciklopedive të huaja dhe i materialeve të tjera enciklopedike shqiptare, si dhe janë përcaktuar parimet dhe kriteret shkencore e metodike të hartimit të Enciklopedisë Shqiptare, janë përcaktuar dimensionet e saj, raportet midis fushave, etj. Ky studim bën të mundshëm fillimin e punës për hartimin e enciklopedisë.
- Janë ngritur redaksitë e fushave, gjithsej 25 redaksi me nga pesë autorë dhe janë lidhur kontratat e punës me përgjegjësit e redaksive.
- Redaksitë, në përputhje me orientimet e dhëna nga redaksia e përgjithshme, pas një studimi të kujdesshëm të literaturës shkencore të fushës përkatëse, kanë hartuar fjalësin (zërat) e enciklopedisë, kanë përcaktuar madhësinë e secilit zë të propozuar, e gjithashtu kanë propozuar edhe autorët që do t'i shkruajnë zërat e enciklopedisë.
- Janë zhvilluar takime e konsulta të shumta për hartimin e kësaj vepre madhore kombëtare, jo vetëm me redaksitë, por edhe me specialistë të tjerë të njohur të fushave të ndryshme.
- Pas miratimit të këtyre materialeve në Redaksinë e Përgjithshme, tashmë është gati të fillojë faza e dytë e projektit, shkrimi i zërave të enciklopedisë dhe lidhja e kontratave me autorët e zërave.

Theksojmë se detyrat e fazës së parë, me gjithë kohën relativisht të shkurtër që nga marrja e financimit e deri më sot, janë realizuar plotësisht dhe tashmë jemi të gatshëm të fillojmë fazën e dytë, pas marrjes së financimit në vazhdim.

Për realizimin e këtij objekti u përdorën një sërë studimesh monografike, artikujsh shkencorë enciklopedish rajonale, fjalorësh enciklopedikë, autobiografi, vëllime me kujtime, organe të shtypit të kohës, vëllime me dokumente historike.

METODA:

Për hartimin e fjalësit u përdorën metodat më të avancuara shkencore që përdoren sot për enciklopeditë. Parimet dhe metodat kryesore që u aplikuan janë:

- Gjithëpërfshirja e tematikave: U bë një punë e madhe që të paraqiteshin sa më gjerësisht dhe në mënyrë përfaqësuese të gjitha sferat e botës shqiptare.
- Risitë në zërat e ESH-it: Për arsye të mungesës së një botimi enciklopedik të mëparshëm, i cili do të mund të përdorej si bazë, u bë një punë e madhe për sjelljen në këtë vepër të shumë e shumë zërave të rinj. Në këtë mënyrë u bë një hap i rëndësishëm përpara për kapërcimin e pasojave të politizimit të shkencave shqiptare gjatë periudhës së komunizmit. Një progres i mëtejshëm dhe konkret do të realizohet në këtë drejtim kur të shkruhen dhe botohen zërat e kësaj enciklopedie.
- Objektiviteti dhe balanca shkencore: Gjikimi në mënyrë objektive i dukurive të ndryshme të botës shqiptare, duke u bazuar në argumente e të dhëna shkencore serioze dhe vlerësimi sa më i mirëpeshuar i vlerës së tyre dhe rëndësisë e dimensionit që kanë në botën shqiptare.

METODA

Metoda thelbësore dhe udhëheqëse ka qenë shqiptarësia. Zërat e enciklopedisë kanë synuar që të jenë detyrimisht subjekte që janë shqiptare, pavarësisht nga hapësira e shtrirjes dhe ekzistencës së tyre, ose subjekte që në një mënyrë apo tjetër lidhen me botën shqiptare. Pikërisht në bazë të këtij parimi udhëheqës janë përcaktuar edhe konturet e tyre.

Metodë e rëndësishme ka qenë ajo krahasuese: Krahasimi i të dhënave, fenomeneve, etj., ka qenë element themelor në ndërtimin e fjalësit.

Unifikimi dhe harmonia, gjithëpërfshirja kombëtare: Bota shqiptare është parë si një e tërë, duke kapërcyer disa kufizime që vërehen në botime të mëparshme enciklopedike shqiptare dhe në botime të tjera, ku shpesh kufijtë politikë kanë ndikuar edhe në botëkuptimin apo në metodat e studimit të fenomeneve të ndryshme.

Metoda e historicizmit: Të gjitha subjektet dhe fenomenet do të studiohen në evolucionin e tyre historik.

Fjalët kyç:

Enciklopedi, shqiptar, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, arbëresh, Ballkan, Europë, ekonomi, gjeografi, politikë, histori, etj.
(përfaqësohen të gjitha fushat e dijes dhe të veprimtarisë).

Fondi i shpenzuar:

Fondi i shpenzuar për studimin, për fazën e parë, është 6350 mijë lekë; Ky fond ka shërbyer për ngritjen e redaksive, takimet e redaksisë së përgjithshme, hartimin e platformës, hartimin e Fjalësit, si dhe për krijimin e një infrastrukture të lehtë (kompjuter, server) në shërbim të projektit.

Ekipi:

Janë ngritur 24 redaksi të fushave dhe një redaksi e përgjithshme, me 135 specialistë të dijes në vendin tonë, në botën shqiptare dhe më gjerë.

Numri i faqeve:

Janë realizuar 389 faqe vetëm për Fjalësin, si dhe 35 faqe për Platformën.

Arritjet:

Fjalësi i hartuar ka shënuar arritje të rëndësishme, pasi ai ka fituar këto dimensione:

- ❖ Është bërë shumë më i gjerë dhe gjithëpërfaqësues për botën shqiptare.
- ❖ Ka fituar një karakter objektiv e shkencor, duke kapërcyer kufizimet e së kaluarës që kishin krijuar seleksionime e përjashtime të figurave, të objekteve e të fenomeneve të ndryshme, diktuar nga ideologjia dhe nga politika.
- ❖ Është ndërtuar mbi kritere të shëndosha proporcionale mes fushave të ndryshme.
- ❖ Zërat kanë fituar dimensionin unik e harmonik gjithëkombëtar.
- ❖ Numri i autorëve të caktuar për shkrimin e zërave është i madh dhe gjithëpërfshirës, duke shmangur çdo tendencë përjashtuese. Përzgjedhja nga redaksitë është bërë tërësisht në bazë të kritereve rigoroze profesionale.

REALIZMET

U realizua njëri prej objektivave të projektit që është hartimi i një fjalësi të plotë dhe koherent, i cili u bazua në studime të gjera shkencore nga redaksitë e fushave dhe nga redaksia qendrore.

Konkretisht u arritën këto përfundime, të cilat jepen në dy tabelat e mëposhtme, duke i krahasuar me treguesit e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (FESH) me ata të Fjalorit Enciklopedik (ESH):

	Nr. i zërave në FESH	Nr. i zërave çështje	Nr. i zërave persona
Gjithsej	7.299	4.861	2.438

	Nr. i zërave në ESH	Nr. i zërave çështje	Nr. i zërave persona	Nr. i faqeve të Fjalësit
Gjithsej	16.814	13.201	3.613	389

Siç shihet, është realizuar vetëm faza e parë e Projektit, domethënë organizimi e ngritja e redaksive, hartimi i platformës së Enciklopedisë Shqiptare, hartimi dhe miratimi i zërave nga redaksitë e fushave përkatëse (Fjalësi i enciklopedisë), caktimi i madhësisë së tyre dhe caktimi i autorëve që do t'i shkruajnë këto zëra.

Mosrealizimet

Për arsye të vlerës së lartë të projektit, është rënë dakord që të lidhet me AKTI-n një kontratë e përgjithshme më datë 08.07.2010, ku është përcaktuar vetëm financimi për vitin 2010 në shumën 2.7 milion lekë. Pjesa tjetër është lënë që të finanohet vit pas viti.

Por ky financim nuk u krye sipas kërkesave të parashikuara të vetë Projektit: në vend të shumës së përgjithshme të projektit, ose të vlerës për të cilën do të duhej të ishte rënë paraprakisht dakord mes agjencisë financuese (AKTI) dhe agjencisë ekzekutuese (QSA), u lëvrua brenda një periudhe më pak se trevjeçare vetëm shuma prej rreth 6 milion lekësh, e domosdoshme për të realizuar vetëm fazën e parë të Projektit.

Tashmë mbeten për t'u realizuar Faza e Dytë, e cila ka të bëjë me shkrimin dhe redaktimin e zërave, si dhe Faza e Tretë, që ka të bëjë me përpilimin e indeksit, shënimin e referencave të kryqëzuara, faqosjen me tekst dhe me ilustrime, redaktimin përfundimtar, botimin në shqip, si dhe përkthimin dhe botimin në anglisht, në letër dhe në formë elektronike, të Enciklopedisë Shqiptare me 10 volume dhe me 1162 faqe tipografike.

REKOMANDIME...

Enciklopedia Shqiptare është një vepër madhore dhe do të jetë një arritje e rëndësishme për kulturën dhe shoqërinë tonë, jo vetëm në aspektin e brendshëm, por edhe në atë ndërkombëtar, pasi deri më sot kulturës dhe botës shqiptare përgjithësisht, u mungon një vepër madhore reference, e cila të shërbejë si pikë referimi për publikun vendas dhe të huaj.

Realizimi i Enciklopedisë Shqiptare dëshmon për seriozitetin dhe përgjegjësitë e shtetit shqiptar në fushën e kulturës.

Gjithashtu, vazhdimi i financimit të Projektit ruan seriozitetin e shtetit, përkatësisht të institucioneve publike të kërkimit shkencor, e sidomos AKTI-t dhe QSA-së, përballë opinionit publik gjithëshqiptar, i cili tashmë është informuar për fillimin e këtij projekti dhe pret konkretizimin e tij;

Duhet vijuar puna me shkrimin e veprës. Për këtë, duhet të akordohet financimi i kërkuar, në mënyrë që të lidhen kontratat me autorët e zërave për shkrimin e artikujve, si dhe me redaksitë për redaktimin shkencor të tyre.